

KËRKESË
Nr. 293/7, datë 15.2.2013
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (toka dhe objekte).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 (objektet), për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit të publikimit, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Lidhur me pasuritë truall, të cilat janë publikuar në periudhën dhjetor 2011 - janar 2012, sqarojmë se po ripublikohen për efekt të çmimit, pasi ka pasur një gabim në referencën bërë në atë kohë, për sa i përket çmimit për pasurinë truall. Në këtë publikim është vënë çmimi i saktë referuar kuadrit ligjor.

Pasuritë, për të cilat është bërë shënimi në kolonën përkatëse “Rikonfirmim”, sqarojmë se nga konfirmimet e dhëna nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ka paqartësi apo mangësi të dhënash ose për këto pasuri nuk është dhënë ende konfirmim nga kjo zyrë. Për këto pasuri do të rimerret konfirmim pranë ZVRPP-ve, Tiranë dhe Elbasan dhe në bazë të konfirmimeve që do të jepen nga këto zyra do të hartohen dhe listat përfundimtare, të cilat do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “E paregjistruar”, me pronarë të paidentifikuar, personat të cilët pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi. Lidhur me objektet, sqarojmë se jemi në pritje të konfirmimit nga ALUIZNI. Në bazë të konfirmimit që do të jepet nga ky institucion, do të hartohen dhe listat përfundimtare, të cilat do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, sqarojmë se pronarët do të kompensohen pas përfundimit të këtij procesi dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

Për objektet, për të cilat është bërë shënimi “Pa dokumentacion/i pakonfirmuar”, sqarojmë se personat që pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre ose të paraqesin dokumentacionin tekniko-ligjor pranë MPPT-së, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, sqarojmë se pronarët përkatës do të kompensohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 81 917 933.86 (tetëdhjetë e një milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tri pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi